



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2019:192036
Datë: 04.12.2024
Numri i dokumentit: 06546990

C.nr.414/13

Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm/ Divizioni Civil, gjyqtari Petrit Curri në çështjen juridike kontestimore të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS), me seli në Prishtinë, kundër të paditurës B.K.nga fshati T., Komuna e Malishevës, me objekt kontesti “Rimbursim dëmi”, vlera e kontestit 717.00 euro, jashtë seancës gjyqësore me datë 04.12.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. **KONSIDEROHET e tërhequr** padia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) me seli në Prishtinë, kundër të paditurës B.K.nga fshati T., Komuna e Malishevës, me objekt kontesti “Rimbursim dëmi”, me numër të lëndës C.nr.414/13 e datës 18.10.2013.
- II. **Anulohet** seanca e caktuar për datën 09.12.2024 prej orës 09:30

A r s y e t i m

Paditësja Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS), me seli në Prishtinë, me datë 18.10.2013 në këtë gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditurës B.K.nga fshati T./Malishevë, për rimbursim dëmi, vlera e kontestit 717.00 euro.

Gjykata disa herë ka caktuar seancë përgatitore, por asnjëherë nuk ka pasur prova se e paditura është ftuar në mënyrë të rregullt, pasi që nga disa fletë kthesa është konstatuar se të njëjtat i ka nënshkruar dikush tjetër, e në disa raste zyrtarët e postës kanë konstatuar se e paditura gjendet jashtë vendit.

Në seancën e fundit të datës 11.11.2024, prezent ka qenë e autorizuar e paditëses, por nuk ka prezantuar e paditura B.K.dhe sipas fletë kthesës ka rezultuar se e paditura gjendet jashtë vendit.

Pasi adresa e të paditurës ka qenë e panjohur (jashtë vendit), gjykata gjatë seancës dhe me aktvendimin procedural C.nr.414/13 të datës 11.11.2024, e ka obliguar paditësen që brenda afatit prej 7 ditëve ta gjej adresën e të paditurës B.K.dhe të njëjtën ta dorëzoj në gjykatë, në të kundërtën padia do të konsiderohet se është tërhequr po që se nuk i kthehet gjykatës brenda këtij afati.

Edhe pas kalimit të afatit 7 ditor, paditësja nuk ka vepruar sipas aktvendimit procedural me numër C.nr.414/13 të datës 11.11.2024 lidhur me gjetjen e adresës për të paditurën, edhe pse ka qenë e paralajmëruar se padia do të konsiderohet e tërhequr në rast se nuk vepron sipas urdhrin të gjykatës.

Me nenin 99.2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) është paraparë që: *“Parashtrësat duhet të jenë të kuptueshme dhe të përmbajnë çdo gjë që nevojitet dhe e mundëson veprimin sipas tyre. Ato duhet të përmbajnë sidomos: emrin e gjykatës, emrin dhe mbiemrin (emërtimin e personit juridik), vendbanimin apo vendqëndrimin (selinë e personit juridik) e palëve, të përfaqësuesve të tyre ligjor apo me prokurë, po që se i kanë, objektin e kontestit, përmbajtjen e deklaratës dhe firmën e parashtruesit”*, ndërsa me nenin 102.1 të LPK-së, është rregulluar situata se si vepron gjykata kur një parashtrësë nuk arrin të jetë e kuptueshme dhe e plotë siç kërkohet me nenin 99.2 të LPK-së, kurse me nenin 102.3, të po të njëjtit ligj, janë paraparë pasojat ligjore të mosveprimit, gjegjësisht veprimit të gabuar të palës ku përcaktohet se: *“Do të konsiderohet se është tërhequr parashtrësja po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtrësja do të hedhet poshtë”*.

Andaj, duke marrë parasysh faktin se edhe pas aktvendimit të lartpërmendur, paditësja brenda afatit të kërkuar nuk ka vepruar në përputhje me urdhrin e gjykatës, dhe duke mos i dhënë shkas gjykatës që të veproj sipas padisë, atëherë gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij

Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.414/13, datë 04.12.2024

Gj y q t a r i
Petrit Curri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.